



Akademia e Dialogut Lokal e OSBE-së për Gratë e Reja

>> Nga data 8 deri më 13 qershor 2019, Hotel Ulpiana, Graçanicë

Gratë e reja - mendjet e ndritshme të sotmes dhe udhëheqëset e së nesërmes!

Bashkoni idetë brilante dhe kreativitetin për t'u lidhur dhe për t'u bashkuar me gra të reja ambicioze dhe aktive, si ju, në një kërkim të guximshëm dhe angazhues që provokon të menduarit. E mirëpresim sfidimin e mendësisë fikse duke ndërmarrë sfida, duke kapërcyer pengesat, duke bërë përpjekje të vazhdueshme dhe kritika konstruktive. A jeni gati për ndryshim?

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) fton gratë e reja ndërmjet moshës 16 dhe 22 nga Kosova të interesuara për pjesëmarrje në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokimit që të aplikojnë në Akademinë e Dialogut Lokal të OSBE-së për Gra të Reja, që do të mbahet nga 8 deri më 13 qershor 2019 në Hotel Ulpiana në Graçanicë.

Rreth Akademisë së Dialogut Lokal të OSBE-së për Gratë e Reja

Akademia për Dialog Lokal e OSBE-së ofron platformë për gratë e reja nga të gjitha komunitetet për të kapërcyer pengesat në komunikim, për të thyer stereotipet dhe për të vendosur bazë për dialog të mëtejshëm përmes të mësuarit nga njerëz tjetra, dhe aktivitetet e trajnimit dhe mentorimit. Synimi është që të nxitet bashkëpunimi, duke u fokusuar në çështje të përbashkëta shqetësuese që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Akademia e Dialogut Lokal e OSBE-së parasheh gjashtë ditë trajnimi, duke përfshirë ushtrime të ndërtimit të ekipit dhe të mësuar nga njëra tjetra, dhe do të mbulojë tema të tilla si barazia gjinore, pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes publike dhe politike, udhëheqja, si dhe trajnimi për shkathtësi praktike (si të shkruani letër motivimi dhe CV, etj.).

Kualifikimet

Ftojme gra të reja mes moshave 16 dhe 22¹ vjeç nga Kosova të interesuara për të marr pjesë në proceset e politikës dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokimit. Aftësitë e gjuhës angleze nuk janë të detyrueshme.

Aplikacioni

Për informata shtesë ju lutemi vizitoni faqen e internetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë www.osce.org/mission-in-kosovo, ose portalin e financimit për Kosovën <https://kosovofunding.org/>.

1. Të miturve do t'u kërkohet të dërgojnë pëlqimin e prindërve të nënshkruar nga të dy prindërit (nëse është e aplikueshme) formulari i të cilit gjendet në pakon e aplikimit.

A po vjen? Shumë mirë, apliko tani!

>> Ju lutemi dërgoni aplikacionin tuaj deri më 15 maj 2019 (23:59) në localDA-OMiK@osce.org

Formulari i aplikimit

Emri:	
Data e lindjes:	
Komuniteti (opsionale):	
Gjinia:	
Detajet e kontaktimit:	
E-mail adresa:	
Emri i shkollës:	
Vendbanimi:	
Ju lutemi, shkruani në një paragraf të shkurtër motivimin tuaj për të aplikuar për Akademinë e Dialogut Lokal të OSBE-së për Gratë e Reja:	
Data e aplikimit:	
Afati i fundit për aplikim:	15 maj 2019

Pranuar nga:
